



Në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4, të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 20, paragrafi 1 dhe paragrafi 3, pika 3.3 e Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas Kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjiçan, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.35/2015 të datës 10.04.2015 si dhe pas Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me datë 30.04.2015, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës

1. Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës - Dega në Gjiçan, për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës për nevoja të Xhamisë në Lagjen “Zabeli i Sahit Agës “ në Gjiçan.**
2. **Lejohet shfrytëzimi i një pjese prej 643 m² të ngastrës kadastrale P-70403013-01880-0, te vendi i quajtur “Zabeli i Sahit Agës”, lloji i njësisë- parcelë, lloji i pronës- pronë shoqërore, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës 25249 m² (02.52.49 ha), shfrytëzimi aktual i parcelës – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë e pakategorizuar, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës – Rrugët.**
3. Sipërfaqja prej 643 m² (ashtu siç është paraqitur në pjesën grafike nga ana e Drejtorisë për Urbanizëm), epet në shfrytëzim pa kompensim dhe ka dedikimin : parking të automjeteve i cili do të shfrytëzohet nga ana e komunitetit fetar të cilët i zhvillojnë aktivitetet fetare në këtë xhami si dhe nga ana e të tjerëve – banorëve të Lagjes “ Zabeli i Sahit Agës”.
4. Afati i shfrytëzimit të kësaj sipërfaqe është 15 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me kusht që shfrytëzimi i të njëjtës nuk bie në kundërshtim me Planet Hapësinore dhe Urbanistike për këtë zonë të qytetit.
5. Obligohet shfrytëzuesi i kësaj hapësire që të njëjtën ta shfrytëzon dhe ta mirëmbajë si nikoqir i mirë me dedikimin për parking të automjeteve dhe i ndalohet që nga kjo pronë të krijojë të hyra financiare pasi që e njëjta epet në shfrytëzim pa kompensim.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta bënë parcelimin e sipërfaqes së dedikuar për parking dhe njësinë e re kadastrale të krijuar pas parcelimit ta evidenton në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Gjiçan.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjiçan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjiçan.
8. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.016-41870
Gjiçan, më 30.04.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

/Valentina Bunjaku –Rexhepi/